

Lucia Nadin

Teksti i parë ose Koha e shpresës*:

Fra Angelo da Bergamo

Relacion i shkurtër mbi gjithçka ka ndodhur nga viti 1634-1640 në misionin apostolik të Shqipërisë, vend i nënshtruar nga sundimi barbar otoman. Relacioni në fjalë është përpiluar nga Fra Angelo Da Bergamo i komisionit reformator të Romës, misionar apostolik i tij, dhe në të përmbahen në mënyrë të përgjithshme natyra e vendeve, e njerëzve, zakonet përkatëse, si dhe konvertimi në masë i popullsisë në fenë dhe besimin e shenjtë të krishterë.

Është relacioni që përshkruan mbërritjen e Françeskanëve në tokat shqiptare: jemi në vitin 1634, misionarët duan të vënë këmbë pas rreth 150 vitesh nënshtrimi të vendit prej turqve. Për ata që i shohin të vijnë është një mrekulli, diçka gati e pabesueshme; gjallërohen pjesë kujtimesh të mbijetuara, hyjnë në jetë njerëzish tashmë me përvoja të ndryshme tek të cilat ndryshimet janë thellësisht të brendësuar. Të rinjtë e sapombërritur nuk mund të mos shihen si të ardhur, ndoshta si bartës planesh politike, të rrezikshëm e pushtues të pashpallur.

Kështu na orienton rrëfimi i Angelo da Bergamo-s, i paraprirë nga një shtjellim i shkurtër mbi çka ka ndodhur më parë në Romë, në proces të planifikimeve të Kongregacionit të Propagandës për tokën shqiptare. Jemi mes viteve 1633-34, kishin kaluar rreth 10 vjet nga themelimi i dikasterit papnor të Kongregacionit të Shenjtë “De propaganda fide”, i krijuar me qëllimin që të promovonte misionin apostolik të Romës kudo nëpër botë e për të

* Ashtu siç kemi vepruar edhe në numrat e mëparshëm me tekstet e françeskanëve të tjerë që përshkruajnë kujtimet e misionit të tyre në Shqipëri në shekullin XVII (SF 1-2, 2021; SF 1-2, 2024), kemi zgjedhur të botojmë në shqip kapitullin përkatës nga artikulli i Lucia Nadin, “‘Santa pazzia’ francescana nell’Albania del secolo XVII”, në: *Palaver* 11, n. 2, 2022, f. 5-90. DOI 10.1285/i22804250v11i2p5. <http://sibaese.unisalento.it>, © 2022 Università del Salento, kapitull i cili ndalet në paraqitjen e tekstit dorëshkrim të fra Angelo da Bergamo-s, të gjetur prej saj në Arkivin françeskan të Venecies, të cilin e kemi përfshirë në rubrikën Materiale dhe dokumente. Teksti që po botojmë në shqip përfshin ff. 12-37 të artikullit të përmendur. (Shënim i redaksisë).

bashkërenduar të gjitha veprimtaritë.¹ Edhe pjesa jugore e Europës, që në pjesën më të madhe kishte kaluar nën sundimin otoman mes shekujve XV e XVI, ishte tashmë një zonë kritike, së cilës i duhej kushtuar një vëmendje e veçantë.

Bënte pjesë në të Shqipëria, që përgjatë gjithë Mesjetës ishte tokë e krishterë, që gjithnjë kishte qenë tokë e privilegjuar në projektet utopike të kryqëzatave nga ana e Papatit, ashtu siç kishte qenë dhe në qendër të interesave politike të shteteve të ndryshme italiane dhe evropiane, mbi të gjitha të Venedikut: pikërisht rreth saj përqendroheshin dhe projektet e përhapjes së fesë nga Selia e Shenjtë. Shpirti i projektit specifik i këtij projekti ishte Gjergj Bardhi, ipeshkëvi i Sapës, i cili në vitin 1632 ishte takuar me At Bonaventura da Palazzolo.

Për misionin në Shqipëri zgjidhen kësajsoj tetë fretën, midis të cilëve dhe Angelo da Bergamo, rrëfimi i të cilit ka mbi të gjitha meritën se përbën pothuajse një parathënie të të gjitha relacioneve të mëvona të misionarëve, duke përshkruar pikërisht fillesat pothuaj të pabesueshme të përballjes së tyre me botën shqiptare.

Bëhet fjalë për një kronikë të shkruar pikërisht në terren, e nënshkruar si e vërtetë prej vetë autorit në çdo pjesë të sajën.

Regjistron kohën kur ndaj kësaj ndërmarrjeje kishte besim, kohën kur ushqeheshin shpresa.²

Të përzgjedhurit hipin në anije në muajin gusht të vitit 1634 në portin e Ancona-s për të mbërritur në Raguzë, në qytetin e rrethuar me mure, ku priten prej zotërinjve raguzanë dhe etërve observantë. Të gjithë çuditen me mbërritjen e tyre, në veçanti pasi u vunë në dijeni që kishin qëllim të vijonin udhëtimin për në Shqipëri. Vijimi i udhëtimit nënkuptonte ekspozimin ndaj një rreziku të

¹ Flasin qartë për këtë gjë faqet e detajuara të përkthyer në gjuhën latine nga Át Basilius Pandžić, OFM, në *Historia Missionum ordinis fratrum minorum, IV Regiones proximi orientis et Paeninsulae Balcanicae, Romae 1974*, ff. 98-101.

² Nga puna e fra Angelo-s në shekullin e kaluar që botuar një pjesëz nga F. Granata, “L’Albania e le missioni italiane nella prima metà del secolo XVII”, mbi bazë dokumentesh të pabotuara, në “*Rivista d’Albania*”, 3 (1942), ff. 226-248, një tekst i nxjerrë pjesërisht nga përmbledhja e C. Libardi-t, me titull “*Sylva documentorum ad Albaniam pertinentium*”, për të cilën kemi folur më sipër. Kërkimet në arkivin e Akademisë nuk kanë dhënë rezultate në lidhje me këtë çështje: ruhen aty vetëm disa letra të Libardit të datuara në periudhën 1939-1940 e që janë përgjigje prej ku del dhe se materialet në dorëshkrim të dërguara prej tij në Romë në të vërtetë nuk kanë arritur kurrë aty. Khs. *Archivio della R. Accademia d’Italia*, dosja 12, fashikulli 151: përmbledhja e plotë mbi këtë çështje është dhënë nga Donato Martucci, *Il sogno di un’opera monumentale. Fonti per la storia d’Albania*, “Palaver”, n. 5 n.s., 2016, ff. 5-58. Khs. edhe G. Valentini, *La famiglia nel diritto tradizionale albanese*, në “*Annali Lateranensi*”, IX 1945, ff. 9-212.

qartë, një përballje me një martirizim të sigurt, meqë me shumë mundësi do të nguleshin në hunj siç ishte zakoni mizor i turqve. Kishte dhe pengesa të sigurta e pothuaj të pakapërcyeshme: kokëfortësia e muhamedanëve, jetesa e shturur e të krishterëve në Shqipëri, njerëz shpesh të egër e të panështruar, gjuha shqipe e vështirë për t'u kuptuar e mësuar. Përpara misionarëve shfaqej një perspektivë vërtet e ndërlikuar.

Ata si rrjedhojë po hynin të përjetonin një vuajtje të madhe e të ligjshme, nuk mund të bënin ndryshe veç t'i drejtoheshin me lutje Hyjit. I kërkuan ndihmë një imazhi fugureje të vendosur mbi një altar të Kishës së Shën Françeskut të Raguzës në të cilën paraqitej Krishti i vënë në kryq me një engjëll në të djathtë e një tjetër në të majtë (të dy engjëjt mbanin një temjanicë në dorë).

Duhet regjistruar qysh prej episodit të parë aspekti mbiracional që e shoqëron këtë ndodhi, dimensionin e një besimi të pakufi në të cilin gjen hapësirë komponentja e mrekullibërjes e përballë së cilës çdo gjykim fundoset.³ Sepse, siç shkruan Fra Angelo, mrekullisht për 13 ditë rresht shihnin të dilte në drejtim të Krishtit temjan nga enët që e mbanin në kishë: qe një sinjal, një shenjë mrekullie që ata e interpretuan si shtysë për të vijuar me ndërmarrjen e tyre, si një shenjë hyjnore të dërguar për ta kapërcyer frikën dhe bindjen për një dështim të sigurt. I vetmi që i inkurajonte në këtë udhëtim, ndryshe prej të tjerëve që përpiqeshin t'u mbushnin mendjen për të kundërtën, qe një atë jezuit predikatar që jetonte në qytet.

Nga Raguzë vendosën t'u shkruanin ipeshkvinjve në Shqipëri, duke shpjeguar që ishin dërguar nga papa dhe në ndihmë të tyre: njëri prej tyre u përgjigj që ishte një gjë absurde, që nuk mund të bëhej, e që ai vetë do të kishte ikur nëse do të hynin në Shqipëri; një tjetër, më pak kategorik, u përgjigj që ishte e pamundur të shkonin që të tetë, maksimumi mund të shkonin vetëm dy prej tyre. Duke pasë kërkuar më tej ndihmë nga Roma, morën përgjigje që kurrsesi nuk do të ndërpritej misioni.

Kaluan katër muaj, fretnit vendosën më në fund që vetëm dy prej tyre të vijonin udhëtimin e që gjashtë të tjerët të prisnin udhëzime ose në tokë veneciane, ose në Puglia.

³ Kuvendi dhe kisha e Shën Françeskut në Raguzë qenë ndërtuar në fillim të shekullit XIV, pasi fretnit minorë u vendosën aty (nga viti 1309). Këtu kronisti mbivendos imazhin e një krucifici tjetër shumë të famshëm të pranishëm tashti në Raguzë, i ruajtur në kishën e Shën Dominikut; një vepër madhore dhe e mrekullueshme e realizuar nga Paolo Veneziano në vitet 1348-1353, në kornizën e drunjtë të pruar të së cilës ishin gdhendur dhjetë profetë e dy engjëj, madje duke mbajtur temjanin. Mbi Raguzën khs. Alberto Rizzi, *Guida della Dalmazia Arte Storia Portolano*, Edizioni Italo Svevo, Trieste, 2010, vëll. II, ff. 303-604.

Qenë zgjedhur ndër ta shumë i përndershmi Atë fra Bonaventura nga Palazzolo dhe shumë i përndershmi Atë fra Cherubino nga Val di Bono, të dy rregulltarë që bënë një jetë të shenjtë; gjashtë fretnit e tjerë u kthyen në Itali. Askush në Raguzë nuk merrte përsipër t'i hipte në anije nga frika se i duhej të shkonte mes turqve dhe ndërkohë koha kalonte. Më në fund një grua e ve, një zonjë prej Raguze dërgoi fjalë që me dëshirë do të paguante dhe do të mbulonte udhëtimin me anije. Kjo ndodhi në vigjilje të festës të Zojës së Papërlyeme, pra, më datën 7 dhjetor.

Dy fretnit qenë shoqëruar nga shumë zotërinj të Raguzës, pothuaj të gjithë qanin e ndjenin keqardhje për ta, meqë mendohej se sapo të mbërrinin, do t'i vrisnin. Imbarkimi ndodhi kësajsoj mes lotëve dhe frikës.

Prej këtyre faqeve të para mund të receptohet dimensionin narrativ i tekstit dhe emocionet që përcjell.

Me t'u nisur mbi një barkëz nga Ragusa, u drejtuan nga Tivari, për t'u ndalur rreth dhjetë milje prej qytetit, në një breg deti të quajtur Pastrovich e që sundohej prej venedikasve dhe që kufizohej në çdo drejtim me turqit. Aty jetonin mjaft të krishterë dhe ortodoksë së bashku, njerëz të egër për nga natyra, trima, me përvojë, gjithnjë të armatosur; aty dy misionarët qenë pritur nga një i krishterë i mirë, që i mbajti të fshehur për një natë, ndërkohë që barkëza kthehej në Raguzë. Gjithnjë ky i krishterë i mirë arriti të gjente një barkë tjetër, e me t'u ngjitur në të, morën udhëtimin drejt Shëngjinit, “në qendër të Shqipërisë” (sic!).

Duhet të kalonin nga Ulqini, një qytet i fortifikuar që ishte në duar të turqve, i banuar nga njerëz që merreshin me grabitje të shpeshta: që të mos zbuloheshin, u desh të udhëtonin natën, por një roje (nuk dihet për ç'arsye) qëllon me armë, fakt që bëri që të shkaktohej një zhurmë e madhe në qytet dhe menjëherë filluan të shtëna nga fortesa duke menduar se bëhej fjalë për një sulm prej armiqve.

Njerëzit në barkë provuan një frikë të madhe, por me ndihmën e Hyjit arritën të iknin dhe mëngjesin tjetër mbërritën në portin e Shëngjinit.

Rremtarët u kthyen mbrapsht, dhe kështu në port mbetën vetëm dy fretnit.

Fraza e kronistit, lapidare, bën të krijohet një pamje e jashtëzakonshme: një breg deti, dy burra të vetëm, pa asnjë mbrojtje apo ndihmë, të zbarkuar në një tokë të panjohur, që fillojnë si të humbur një rrugëtim duke pasur ndër mend fjalët e Krishtit të lexuara në Ungjillin simbas Lukës e simbas Mateut: “...shkoni... dy nga dy... unë ju dërgoj si qengja në mes të ujve; mos mbani me vete torba, trasta, as sandale”.

Vështirë që kush lexon këto rreshta mund të shqitet lehtë nga pamja e dy siluetave të lëna vetëm në një breg deti të shkretë. Leximi ngarkohet me ankth pritjeje, duke bërë të shtohet padurimi i njohjes së vijimit të ngjarjes, që i ngjet pikërisht atij të një romani.

Jemi afër Krishtlindjeve të vitit 1634, por koha për dy fretnit, (ndryshe prej lexuesve që e ndjekin atë), Bonaventura e Cherubino, ishte si e mbetur pezull.

Duhet të drejtoheshin drejt pjesës së brendshme, kërkuan ndonjë rrugë, u ndeshën me një vend të quajtur Renesi [Renci], të banuar nga myslimanë dhe të krishterë. Aty mbërritën disa të krishterë, mjaft të lumtur për ardhjen e tyre të papritur, i pritën mirë dhe natën tjetër i përcollën në Zadrinë te ipeshkvi i Sapës që i mbajti të fshehur në shtëpinë e tij për pesëmbëdhjetë ditë; më tej i përcollti deri në majën e një mali shumë të lartë, i quajtur mali i Shën Mhillit ku gjendej një kishë shumë e moçme e shën Mhillit, duke u dhënë atyre një përkthyes që do të duhej t'i ndihmonte.

Brenda asaj kishe dy fretnit u desh të rrinin të fshehur për afro gjashtë muaj, me një vështirësi të madhe në zbritjen drejt luginës për të siguruar mjete jetese: në të vërtetë një ushtri turke kishte mbërritur aty dhe kishte vendosur njësitë e veta pikërisht në rrëzë të malit; për më tepër dimri ishte fort i vështirë, me shumë borë dhe të dy kishin me vete vetëm një palë rroba dhe mantelin.

Por lajmi për praninë e tyre u përhap shpejt. Ndokush thoshte që nuk bëhej fjalë për fretën, por për të birin e mbretit të Spanjës dhe të vëllain e perandorit, të maskuar me veshje murgjish që të mund të spiunonin vendin e të shkaktonin ndonjë veprim kryengritjeje të të krishterëve. Dy fretnit, që nuk merreshin me çka thuhej, po përgatiteshin të konkretizonin veprimin e tyre ungjillëzues, gjë që u bë e mundur në kohë Pashkësh (pra, më 1635), kur ushtria turke ngriti çadrat nga rrëza e malit dhe kështu këta të dy, të shoqëruar nga përkthyesi, filluan të mbërrinin në qendra të ndryshme të po atij mali. Për të dëgjuar predikimet e tyre vraponin jo vetëm të krishterët, por edhe myslimanët që ishin kureshtarë për çka ndodhte e u duk dhe si një shenjë hyjnore suksesi që fretnit mbërritën pothuaj menjëherë të shëronin të sëmurët, madje dy të pushtuar nga djalli. Për më tepër, i thërrisnin që t'u bekonin arat, të mbjellat dhe vreshtat që t'u çliroheshin nga dyndja e krimbave që ishin të shpeshtë në pranverë.

Një ditë At Bonaventura, ndërsa po bekonte ato toka, u zu rob nga vojvoda i vendit, por të gjithë banorët, qoftë të krishterë, qoftë myslimanë, mbasi morën vesh që frati ishte lidhur e mbajtur rob, u vunë ta ndiqnin atë dhe ta shtrëngonin ta lironte. Mbas disa ditësh, u hap fjala që ai vojvodë që e kishte zënë rob kishte humbur aftësinë e të folurit dhe ishte në një gjendje fort të keqe shëndetësore. Pa dyshim që kjo çështje qe interpretuar si një dënim hyjnor dhe ndikoi që të rritej prestigji i fretënve. Në këto shprehje kolektive në favor të fretënve duhet të kuptohet, besojmë, edhe që sundonte dëshira për gjëra e ndodhi të reja që prishnin monotoninë e jetës së fshatrave të ndryshme, e një gjë e tillë vlente si për të krishterët, si për myslimanët.

Fretnit nuk donin të qëndronin vetëm në një vend, donin të vijonin drejt zonash të tjera e zgjodhën të shkonin në fshatin më të varfër të Zadrinës, në luginë: atje u pritën me gëzim nga të krishterët që jetonin aty e që u kujdesën të

ndërtonin për ta një shtëpizë krejt kashte. Nododhi që mes kacafytjesh mes njerëzve të malit e atyre të luginës, të parët, duke mos ditur që ajo kasolle ishte strehëza e fretënve, i vunë asaj zjarrin. Fretnit arritën të shpëtonin vetëm disa gjëra të domosdoshme që u duheshin për të thënë meshë (që ruheshin sipër altarit) e të frikësuar nga klima e dhunës që i dallonte njerëzit që jetonin në male, vendosën të transferoheshin ndonjë milje më larg, në një vend të quajtur Troshan.

Por kishin nevojë për pajime e orendi të shenjta, e kishin filluar të kuptonin që vetëm dy njerëz nuk mjaftonin për të operuar, duheshin misionarë të tjerë, në mënyrë që veprimet e tyre të kryheshin në forma më të organizuara. Kështu u vendos që të rrinte në Troshan Át Cherubino e që Át Bonaventura të kthehej në Itali që të kërkonte përforcime.

Ky i fundit shkoi në Romë, arriti të siguronte ndihmat e kërkuara, u emërua Epror dhe prefekt i Misionit, mori me vete tetë misionarë me të cilët arriti në Venedik për të marrë anijen. Mbas pothuaj një muaji misionarët arritën në fshehtësi të plotë në Shqipëri, e atje u ndanë dy nga dy, kush drejt maleve e kush drejt ultësirës.

Në këtë rast kronisti nuk specifikon vendin e zbarkimit, por mendon që itinerari i ndjekur të ketë qenë si i mëparshmi, pra: pika e nisjes Venediku, më tej Raguza, Tivari, Pastrovici, Shëngjini.

Me imazhin e përforcimeve të mbërritura, që nënkupton një imazh shprese, përmbillet, si të themi, pjesa e parë e ndodhive, pothuaj si një parashtrësë, e para se të hyjmë në gjallërinë e asaj çka vjen më pas, fra Angelo e sheh të arsyeshme të japë një përshkrim të Shqipërisë apo të Epirit, siç preferojnë të tjerë ta quajnë atë tokë:

Shtrihet nga Tivari në Vlorë në rreth dyqind mijë milje në këmbë, edhe pse siç thonë disa, ky vend përfshin edhe territoret sipër Vlorës, pikërisht për arsye të gjuhës së përbashkët. Nga bregdeti vendi është rreth tetëdhjetë milje në këmbë nga Serbia, duke numëruar njëmbëdhjetë qytete: Tivari, Ulqini, Shkodra (metropoli më i fuqishëm), Lezha, Kruja, Elbasani, Durrësi, Vlora, Gjakova, Prizreni, Qyteti i Ri [Novipazari – red.]. Shumë prej tyre ishin shkatërruar nga luftërat. Disa ishin të venecianëve, disa kishin qenë të Skënderbeut, disa të tjera të mbretërve të Serbisë, të gjitha aktualisht banoheshin prej turqve dhe prej pak të krishterëve që nuk ishin konvertuar. Turqit i mbajnë keq, saktëson relatori, sepse kujdesen vetëm për fortesat ku banojnë vetë me shërbëtorët e tyre. Banesat janë pjesërisht me mure e pjesërisht me kashtë. Të gjithë të krishterët e Shqipërisë jetojnë sipas ritit latin dhe roman, janë të devotshëm ndaj Papës, shumë të lidhur me Republikën e Venedikut, që e çmojnë si prijës të tyre. Janë të rrethuar nga një pafundësi skizmatikësh që jetojnë sipas ritit grek, që nuk njohin Papën si vikar të Krishtit, i besojnë patriarkut të Stambollit, Kiril Aleksandrinit, rrojnë nën tirani duke mos pasur një prijës nga i cili turqit të

kanë frikë. Kanë manastire shumë të bukura, por jashtë Shqipërisë, me njerëz e priftërinj mjaft të kulturuar, ndryshe prej atyre latinë.

Është ky një pasazh që paraprin shënime të tjera të kronistit mbi padijen e përfolur të klerikëve, padije që do të kishte pa dyshim rrjedhoja të rënda qoftë në planin personal, duke i bërë të thyeshëm për shkak të marrëveshjeve me qeveritarët, qoftë dhe në plan të raporteve me besimtarët, të cilëve u transmetonin një religjiozitet mjaft të zbehtë e jo përherë konform rregullave të doktrinës. Myslimanët e Shqipërisë, vijon fra Angelo, rrjedhin nga të krishterë renegatë, për këtë arsye kanë mjaft familjaritet me ta dhe shpesh martohen me gra të krishtera. Janë shumë kryelartë dhe nëse takojnë një të krishterë apo një prift të hipur në kalë, ky i fundit duhet të zbresë e t'u bëjë temena, ndryshe i marrin kalin dhe e rrahin. Kanë disa gra, që dalin nga shtëpia përherë me kokë të mbuluar.

Në zonat malore jetojnë më së shumti të krishterë që emërtohen "Aini" nga turqit (shqip: hajn, -i), që do të thotë hajdut: janë rreth tetëdhjetë mijë, nuk kanë qenë kurrë të nënshtruar, janë shumë të fortë dhe nuk mbërrihen lehtë nga ushtritë, për shkak të rrugëve të rrëpirta ose që mungojnë plotësisht. Për më tepër kanë banesa prej kashte dhe në rast të sulmeve nga turqit u vënë flakën dhe zhvendosen në zona të tjera. Njerëzit që jetojnë në zonë fushore kanë shumë frikë prej tyre dhe kur duan të ngrenë hapësira tregtie u dërgojnë atyre dhurata, duke qenë se druajnë se mund t'i sulmojnë.

Ata kanë ligjet dhe rregullat e tyre.

Çdo fshat zgjedh kreun e vet, që e quajnë Qefali, e në rast të veçantë mblidhen të gjithë bashkë për të marrë vendime. Nuk ka kush ta ushtrojë drejtësinë, çdonjëri e bën në mendje të vet. Nëse vret dikë, duhet t'u paguajë treqind skuda të afërmeve të të vdekurit. Deri para njëzet vjetësh (gjithnjë siç shkruan fra Angelo) nuk kishin parë kurrë priftërinj, vetëm ndonjë që nga zona fushore vinte dy herë në vit për të pagëzuar të porsalindurit.

Nëse gruaja, për të cilën të atit të saj i paguhet një prikë, nuk bën fëmijë, ajo dëbohet dhe zëvendësohet. Janë të shumtë ata të cilët kanë disa gra. Mes të krishterëve mbretëron padija. Më të shumtën në gjithë Shqipërinë janë rreth dhjetë veta që mund të dinë të lexojnë (një e dhënë kjo shumë e rëndësishme, që duhet shënuar).

Ushtarët turq kanë jo pak shtëpi të krishterësh të cilat i shfrytëzojnë për të vjelë taksa e mjete jetese. I trajtojnë si skllevër të vërtetë e akoma më keq do t'i trajtonin po të mos kishin frikë nga të krishterët "e maleve". Çdo vit dërgohet një gjykatës apo kadi. Sa i përket besimit, turqit nuk ua ndalojnë të krishterëve që të shkojnë në ato pak kisha që janë, duke i respektuar pa asnjë pengesë. Nëse kishat e vjetra rrenohen, ata lejojnë që të rindërtohen, por vetëm mbasi të jetë marrë një leje e veçantë.

Marrin pjesë në meshë, duke pagëzuar edhe fëmijët, por e bëjnë këtë për arsye shëndetësore, pra, me qëllimin që të sigurojnë shëndetin e mirë.

Në përshkrimin e shkurtër përvijohen kufijtë e territoreve të Shqipërisë apo Epirit, të përbashkuar nga e njëjta gjuhë, bëhet me dije një analfabetizëm i theksuar, nguliten zakonet e ndryshme mes njerëzve të maleve e atyre të zonave fushore, fotografohet skllavëria e të krishterëve të zonës fushore e në të kundërt, fuqia rebele e banorëve të maleve, regjistrohet një përzierje mes myslimanësh e të krishterësh në ritet e këtyre të fundit, edhe pse nuk ka të bëjë me çështje besimi, por me njëfarë bestytnie me qëllim ruajtjen e shëndetit. Pikërisht kjo përzierje është një e dhënë me rëndësi, një element që nuk duhet lënë pa vëmendje në historinë e vendit, si rrjedhojë e ndryshimeve të ndodhura për më se një shekull, që kur Shqipëria ishte bërë pjesë e Perandorisë Otomane.

Pasi mbyllet kuadri tërësor i përshkrimit, hyhet në thelbin e gjallë të rrëfimit, që zë fill me mbërritjen e forcave të reja misionare në Shqipëri: të ardhurit e rinj ishin tetë, do të bëheshin gjithsej dhjetë ata të cilëve u takonte të kryenin punën në terren. U mblodhën të gjithë në oratorin e Troshanit i quajtur “i Marisë ngadhënjimtare”, siguruan njohjen nga ipeshkvijnjtë, dhe bashkë me përkthyesit u shpërndanë për të filluar predikimin e tyre. Ata që u nisën në drejtim të Serbisë dhe Shkupit gjetën mjaft të krishterë të kthyer në myslimanë. Në Gjakovë, p.sh., vetëm njëzet shtëpi kishin mbetur të krishtera.

Ati epror i Misionit, Bonaventura, për të organizuar më mirë veprimet e misionarëve vendosi të ngrinte katër oratorë, me distancë rreth dy ditë udhëtim prej njëri-tjetrit: i pari në Troshan, në Zadrimë, ku mbeti si kryesues i misionit vetë Bonaventura me dy shokë të tij; i dyti në malet e banuara nga njerëz shumë të egër të quajtur mirditorë, ku shkuan Angelo da Bergamo (shkruesi i këtyre radhëve) dhe Francesco da Lucca. I treti në Trush në afërsi të Shkodrës, më i vështiri për t’u drejtuar për arsye të afërsisë me Shkodrën dhe ashpërsisë së qeveritarëve ndaj të krishterëve, ku shkoi fra Cherubino me një shok të tijin. Në Iballe shkuan Gregorio da Novara, Bernardo da Verona dhe Benedetto da Treviso. Situata më e vështirë, e thamë dhe më sipër ishte ajo e Trushit, duke qenë strehë e turqve dhe për këtë edhe kuptohet pse u zgjodh misionari me më tepër karizmë, pra, fra Cherubino. Fati e deshi që në kohët më të para të themelimit të oratorit sanxhakbeu ishte jashtë qytetit dhe që e ëma e tij që lëshoi lejen për ta ngritur; shumë shpejt erdhën aty shumë myslimanë për të parë altarin dhe një imazh shumë të bukur të Virgjëreshës Mari; edhe vetë priftërinjtë shkuan aty e ishin të shumtë ata që sollën lule; e ndërkohë, po aq të shumtë në numër, vijuan të shkonin qoftë të krishterë, qoftë myslimanë, dhe pse në qytet u përhapën zëra që fretnit ishin spiunë të mbretit të Spanjës.

Një skenar që prek gjithmonë është përzierja mes myslimanësh e të krishterësh që frekuentonte, dhe pse me arsye të ndryshme, oratorin.

Një ditë dy myslimanë i kërkuan fra Cherubino-s të shkonte në qytet që të shëronte me lutjet e tij një të sëmurë, duke e siguruar që askush nuk do t’i bënte keq.

E morën dhe e çuan në drejtim të fortesës (ku kishte qenë kuvendi i Shën Dominikut) dhe frati i shkretë u ndje i tradhtuar, por arritën në fund në afërsi të portës së fortesës. Erdhën shumë zotërinj myslimanë që të ishin të pranishëm në ndërhyrjen e fratit, që, pasi e sollën në dhomën e të sëmurit, shtjelloi eksorcizmat e tij, duke i vendosur në rroba një relikuar dhe shkrime të ndryshme fetare. Pas disa ditësh i sëmuri u shërua dhe më pas i qe gjithmonë mirënjohës Fra Cherubino-s.

Fama e fretënve dhe e veprimeve të tyre po përhapej në Shkodër, duke shkaktuar në një kohë të shkurtër thashetheme e duke nxitur dhe zemërimin e sanxhakbeut. U hapën fjalë që fretnit ishin më se njëqind, të gjithë të ardhur për të tradhtuar vendin. U dërguan ushtarë në orator, u hodhën përtokë altari dhe enët me të cilat celebrokej mesha, u nxorën jashtë fuguret e shenjta.

Ndërkohë në Shkodër situata po bëhej e ndezur për arsye të inkursioneve të vazhdueshme në luginën e Kelmendit, të krishterë të zonave malore të Mbishkodrës, në një konflikt të përhershëm me qeveritarët; bëhej fjalë gjithnjë për burra shumë trima, me një pamje madhështore, të mësuar me grabitje e vjedhje të vazhdueshme. Dërgohet kërkesë në Stamboll për të sjellë forca të mjaftueshme për t'i shpartalluar në mënyrë përfundimtare e kështu arrin një ushtri me rreth tridhjetë mijë ushtarë për të mposhtur rreth shtatëqind kelmendas: të gjitha malet – të mbuluara me borë sepse ishte dimër – rrethohen. Gra e fëmijë strehohen në një shpellë të madhe, burrat zbresin për të luftuar, gjithnjë duke qenë në epërsi ndaj sulmuesve. Kështu do të kalojnë tre muaj. Pashai që udhëheq ushtrinë është i dëshpëruar që me një numër i madh ushtarësh nuk arrin të fitojë kundër pak kelmendasve, tenton të sigurojë ushqime e municione nga qyteti i Bulgoricës [Podgoricës - red.], por ndihmat zbulohen në befasi dhe sërish forcat turke rezultojnë të humbura.

Pashai vijon të përsëritë që nuk ekziston ferr tjetër përveç maleve të Kelmendit, që nuk ka djall tjetër përveç atij populli. Kështu vendos të ngrejë kampin e të kthehet në Stamboll.

Ai kishte dhënë leje që fretnit të qëndronin në gjithë Shqipërinë, por me t'u nisur, sanxhakbeu i Shkodrës dhe ai i Dukagjinit, u mblodhën me krerët e Ulqinit dhe të Tivarit dhe vendosën që të gjithë fretnit duhet të dëboheshin, pasi të paraqiteshin më parë para tyre. Iu tha fretënve që brenda tri ditësh duhet ta linin vendin, përndryshe do të dënoheshin me vdekje apo ngulje në hu. Por fretnit u paraqitën të palëkundur, të gatshëm të pësonin çdo martirizim me kusht që të vazhdonin misionin e tyre; u mblodhën në kuvendin e Troshanit, duke marrë vendim që të mos e linin asnjë moment dhe të mos i afroheshin Shkodrës. Ndërkohë erdhi një urdhër nga Roma që ati prefekt i misionit të shkonte në Kotorr me një predikatar dhe kështu u zgjodh fra Angelo da Bergamo. Vajtja në Kotorr nuk qe pa aventura: mes Ulqinit dhe Tivarit të dy u zunë rob, por më tej u liruan pasi iu grabitën medalje, kryqe, simbole të Krishtit agnus Dei.

Kështu dendësoheshin re të reja mbi Shqipërinë, për shkak të një ndeshjeje me armë që kishte ndodhur me venecianët në Vlorë e si rrjedhojë turqit shtonin persekutimin ndaj të krishterëve, të akuzuar se ishin filovenecianë. Fati deshi që të mbërrinte lajmi i pushtimit të Babilonisë nga turqit e kështu përgatitjet për festime bënë që të kalonte në plan të dytë çështja e fretënve, të cilët pak nga pak mundën t'u riktheheshin predikimeve të Ungjillit, duke jetuar në njëfarë qetësie.

Viti 1639 do të mbetej në kujtesën e fretënve si një vit vuajtjesh, e për disa prej tyre dhe të një gjendjeje të rëndë burgimi në burgje të ndotura. Në Shqipëri do të mbërrinte një zotëri shumë i fuqishëm, i mbiqajtur Xhabi, mbledhës takdash, që të mblidhte të dhjetat nga të krishterët e të vendoste drejtësinë.⁴

U tregua menjëherë shumë i hapur ndaj të krishterëve, në veçanti me ata të Zadrimës, të cilët shkuan në delegacion që t'i shtjellonin vuajtjet e pafund që i kishin kapluar (në veçanti nga beu i Lezhës), duke marrë dhe sigurinë që do të kishin mbrojtje dhe drejtësi. Këta të krishterë mundën të rimarrin dhe mbështetjen për fretnit, duke siguruar dhe ndërtimin e një shtëpize me mur e me enë, duke qenë se e mëparshmja, e bërë prej kashte ishte djegur. Në këtë mënyrë fretnit u strehuan në një banesë të re, e gjatë tridhjetë këmbë, e gjerë njëzet, e lartë sa dy krahë e gjysmë dhe e ndarë në dy pjesë në pjesën e brendshme: një pjesë për funksionet e një pjesë për të banuar.

Por keqdashja e shumë myslimanëve kundër banorëve të Zadrimës ishte paracaktuar të rritej. Kështu, po thuhej që fretnit, të thirrur pikërisht nga të krishterët e Zadrimës, kishin ardhur në Shqipëri që të ndërtonin një fortesë për venecianët dhe që ata shpërndanin fletushka me armët e shën Markut, që nuk u jepnin ndjesë grave të krishtera që ishin të martuara me myslimanë që të krijonin qejfmbetje dhe mosmarrëveshje familjare, që nuk pranonin të pagëzonin fëmijët e tyre për arsye shëndeti, e që si përfundim, do t'i konvertonin të gjithë banorët në fenë e krishterë.

Protestuan te Xhabiu dhe e bënë të shkonte në oratorin e Troshanit që të shihte ndërtesën e re të ngritur për fretnit nga të krishterët vendas. Me të mbërritur aty, Xhabiu filloi të qeshte, ngaqë kishte parë manastire në Stamboll e vende të tjera. Pra, për një shtëpizë me thupra po bëhej gjithë ajo zhurmë? Ndërtesa për të cilën i kishin folur ishte pothuajse një barakë e thjeshtë. Gjithsesi, nuk mund të merrte një pozicion të qartë në favor të fretënve dhe që i detyruar të thoshte që duhet të kishin persona të gatshëm që të dëshmonin qëllimin e mirë të misionarëve, ndryshe do të duhet të procedonte e t'i dëbonte prej aty. Xhabiu druante se zotërinjtë e Shkodrës që nuk i donin fretnit dhe ishin kundër të krishterëve të Zadrimës, do të protestonin në Stamboll kundër

⁴ Ky rrëfim do të mund të lexohet dhe në tekstin pasues të Át Cherubino-s me të dhëna të detajuara: për të mos përsëritur të njëjtat episode këtu do të bashkohen tregimet e të dyve.

tij dhe për të qetësuar njerëzit, dha urdhër që në fund të rrezohej ky ndërtime, duke u premtuar të krishterëve që më tej, pasi të mbyllej çështja, do të mund të ndërtonin një tjetër.

Trazirat në Shkodër vazhdonin. Xhabiu që detyruar t'i thërriste sërish fretnit, që ndiheshin të ngushtuar, më shumë të vdekur se të gjallë, duke menduar se i prisnin vuajtje e mundime të mëdha.

Shkuan aty zv.prefekti, fra Cherubino, fra Carlo Mirandola e frati Evangjelist nga Venediku (më i riu nga të tre), të shoqëruar nga një numër i madh njerëzish që qanin, arritën te pallati i Xhabiut. Mbase u morën në pyetje, i çuan në burg, më tepër me qëllimin e Xhabiut për t'i shpëtuar nga pesë krerët e qyteteve të mëdha: Shkodrës, Tivarit, Ulqinit, Lezhës, Krujës, që ndërkohë ishin mbledhur për të kërkuar me ngulm dorëzimin e tyre, duke kërcënuar me shkatërrimin e krejt Zadrimës e të banorëve të saj, që i quanin “kaurë”, pra, të pafe, pasi kishin mbledhur rreth tre mijë njerëz.

Dhe po aq njerëz mblodhi dhe Xhabiu, që pretendonte të kishte të drejtën të ishte ai gjykatësi, duke i pasë gjetur fretnit në territoret e tij. Çështja po bëhej përherë më kritike, u vendos të zgjidhej nga Mehmet Beu, më i pari dhe më i fuqishmi i vendit. Ky i fundit u tregua i gatshëm t'i mbante afër vetes fretnit derisa të qetësoheshin njerëzit, duke marrë përsipër t'ia dorëzonte Xhabiut sapo kjo gjë të ndodhte. Shkuan ushtarët e tij, i morën fretnit, i lidhën, i çuan te beu, aty u gjunjëzuan për të thënë lutje, ndërkohë që ishin të rrethuar nga një numër i madh myslimanësh.

Më në fund i sollën në pallat për t'u marrë në pyetje.

Ishte fra Cherubino që u përgjigjej pyetjeve, duke qenë se zotëronte shkëlqyeshëm gjuhën shqipe: kush ishin, me ç' autorizim kishin ndërtuar kishë, pse e kishin bërë të krishterë një grua.

Fra Angelo u përgjigj që ishin fretën venecianë, që ishin aty për të predikuar Ungjillin shenjt, që nuk kishin ndërtuar një kishë, por vetëm një banesë të vogël e që nuk detyronin asnjëri që të pranonin fenë e krishterë, që gruaja për të cilën bëhej fjalë ishte e pagëzuar që e vogël dhe që me vullnetin e saj kishte dashur të bëhej e krishterë. Beu u propozoi të tre fretënve që të bëheshin myslimanë: do të kishin si këmbim ndere, do të bëheshin pazhë të tyre, do të kishin gra të bukura, kuaj, veshje luksoze, armë të bukura. Shpresonte të bindte mbi të gjitha më të riun e fretënve, sepse pikërisht për moshën që kishte, mund të tundohej.

Duke qenë se vijonin të refuzonin, qenë hedhur në një stallë të pisët, plot me papastërti, që vinte erë. Natën disa të krishterë arritën të hyjnë, t'u sillnin pak bar për t'u shtrirë, pak bukë dhe ujë. Por qenë të rrethuar nga turqit: ditën disa u hidhnin fretënve çdo lloj papastërtie, natën atyre u vihej në qafë një zinxhir dhe më tej i mbërthenin me të njëjtin zinxhir me të tjerë keqbërës, myslimanë e të krishterë. Më në fund fretnit i çuan në pallatin e Xhabiut: ishte data 13 qershor – dita e Shën Ndout – ku sërish ishin mbledhur zotërinjtë e të

pesë qyteteve të sipërpërmendura, gjithnjë më të egërsuar, çdonjëri duke folur kundër tyre.

Koha kalonte e fretnit çdo pesëmbëdhjetë ditë merreshin sërish në pyetje se kush në të vërtetë i kishte dërguar; kishin kaluar më se njëqind vjet që kur vendi ishte pushtuar nga turqit dhe asnjë italian nuk kishte vënë këmbë e si rrjedhojë ardhja e tyre në Shqipëri duhet të fshihte qëllime sekrete. Fretnit përgjigjeshin që kishin ardhur aty me kërkesë të Papës, që nuk kishin plane të caktuara në kohë, por kishin një qëllim të vetëm: të fitonin shpirta.

Ndërkohë, marrësit në pyetje vazhdonin: çfarë nevojë kishte të vinin ata, duke qenë aty ipeshkvinjtë dhe priftërinjtë? Përgjigjja ishte që këta të fundit nuk arrinin të kryenin siç duhej ushtrimet e mësimave të fesë dhe për këtë arsye kishin ardhur këta vetë. Pra, atëherë: myslimanët të gjithë duhet të bëheshin të krishterë? Dhe pse dilnin të veshur aq mjerisht? E ndërkohë hoxhallarët e pranishëm vijonin të diskutonin me fretnit mbi të dyja besimet, e t'u kujtonin atyre që myslimanët nuk përçmonin Krishtin, Marinë, shenjtorët duke i konsideruar profetë, ndërkohë që katolikët e Perëndimit e kishin vendosur profetin e tyre në ferr.

Njëkohësisht me burgosjen e tre fretënve, ishte kapur dhe një grua e re myslimane që kishte dashur të konvertohej pasi i kishte frekuentuar ata. E kishin çuar në xhami dhe e kishin marrë në pyetje, ishte vetëm pesëmbëdhjetë vjeçe, në vogëli ishte pagëzuar, quhej Jakoma.

E pyetën: Ishte kushtëzuar nga fretnit? Jo, u përgjigj ajo; ishte pagëzuar që e vogël, siç bëjnë shpesh jo të krishterët për të mbrojtur fëmijët e tyre, por pastaj kishte zgjedhur të bëhej e krishterë. Filloi kështu tortura e së resë: i qe vënë një litar në qafë, e varën në një dru duke e lënë pezull, më tej e lëshuan përtokë duke e pyetur: do të kthehesh prapë myslimane apo do të vdesësh? E reja u përgjigj po njësoj dhe atëherë e varën sërish dhe e lanë aty derisa qe duke dhënë shpirt.

Ndërhyri Xhabiu duke kujtuar që besimi mysliman nuk parashikonte konvertime të detyruara, por vetëm me dëshirë, sepse një mysliman që bëhej i tillë me pahir nuk do të kishte qenë kurrë një mysliman i mirë dhe si rrjedhojë gruaja e re nuk duhej të shtrëngohej: ta linin të shkonte, t'i zhvishte rrobat e gruas myslimane, të vishej si e krishterë, të mbante emrin e saj si e krishterë dhe të lejohej të jetonte me kaurët (nënkupto: të krishterët).⁵ Dhe ashtu u bë.

Tre fretnit vazhdonin të mbaheshin në burgun e Xhabiut, që gjithsesi duhet të ndiqte një linjë të fortë për të mos ushqyer përplasjen me krerët turq të qyteteve të tjera, e që në fund u lejonte fretënve që të shoqëruar prej gjashtë ushtarësh të shkonin në shtëpinë e një të krishtere ku mund të thonin meshët e

⁵ Mbi kuptimin e saktë të këtij cilësimi përbuzës le të shihet më tej, shkrimi i Leone da Cittadella-s. Këtu Angelo da Bergamo regjistron vetëm mënyrën e të quajturit të të krishterëve *kaurë/ kaurë të mallëkuar* dhe *kaure/ kauresha* (për gratë e krishtera).

tyre e ku shkonin mjaft të krishterë e myslimanë të atij vendi për t'i dëgjuar. Në darkë riktheheshin në burg me hekura në qafë dhe fretnit çdo mbrëmje i puthnin ato hekura dhe personat që duhet t'ua vinin ndienin dhembshuri të madhe dhe keqardhje dhe u kërkonin ndjesë për detyrën që u ishte ngarkuar të kryenin. Fretnit me dy qirinj brenda në burg thonin lutjet e tyre dhe përfshinin edhe të burgosurit e tjerë. Shumë të krishterë ngrinin krye në burg dhe njëzet prej tyre thoshin që ishin të gatshëm dhe të jepnin jetën nëse fretnit i çonin drejt dënimit me vdekje. Begu që kërkonte të hiqte prej vetes këtë peshë, ia besoi fretnit një të krishteri, duke thënë që nëse i linte të iknin do të bëhej dhe ai vetë skllav.

Gjendja e burgimit përmbylej më datën 6 tetor dhe jehona e saj me sjelljen e mrekullueshme të të burgosurve, të lidhur me zinxhirë natën, por të lirë gjatë ditës për të thënë meshë, për të bekuar arat, për të shpërndarë ujë të bekuar që kërkohesh shumë prej të krishterëve dhe po aq prej myslimanëve, kishte bërë që ditë pas dite të shtohesh vlerësimi dhe konsiderata e të gjithëve ndaj fretënve, të bërë tashmë një shembull i qartë i një jete të admirueshme.

Por shëndeti i frat Evangjelistit ishte dëmtuar mjaft në ata pesë muajt çrregullimesh, prandaj u dërgua në Kotorr, ku Francesco Bolizza ishte angazhuar mjaft për rastin e tyre, por jeta e tij u ndërpre pak a shumë në atë kohë. Trazimet dhe shqetësimet kishin lënë shenjë dhe në shëndetin e fra Cherubino-s.⁶

Më në fund ndërhyri bajlozi i Venedikut në Stamboll dhe arriti të siguronte që fretnit të mund të qëndronin në Shqipëri pa pësuar më trazime.

Dhe pikërisht me këtë marrëveshje zyrtare mbyllet relacioni i fra Angelo da Bergamo-s, që e nënshkruan në vitin 1640 duke deklaruar si autentike çdo gjë që ka rrëfyer.

Disa konsiderata

Jemi përballë tregimit të gjashtë viteve jetë të misionarëve françeskanë në Shqipëri, që nga mbërritja e dy fretënve të parë deri në përfundimet e mëtejme, nga muajt e parë në të cilët ishin klandestinë nëpër male deri në evidentimin e vendeve bazë të përndarë në distanca rreth dy milje njëri prej tjetrit ku dhe shtjellohet misioni, ndodhin burgosjet e para dhe më tej çlirimi i tyre.

Nga teksti arrijmë të njohim reagimet më të para të popullit, të thënat e para të tyre: nuk bëhej fjalë për fretën, por për persona që nën petkat fetare ishin dërguar nga mbreti i Spanjës dhe nga perandori për të organizuar veprime politike për të pushtuar vendin. Pra, pas një shekulli e gjysmë pushtimi otoman, në vend vijonin të dëgjoheshin zëra mbi plane destabilizuese që u visheshin fuqive evropiane.

⁶ Studimet mbi historinë e misioneve kanë arritur të vërtetojnë që jeta mesatare e një frati, mes trazimesh, paretatish, kequshqyerjeje e vuajtjesh, ishte rreth tridhjetë vjeç.

Dhe në fakt, një provë e akuzë e sigurt që mund t'u bëhej fretënve ishte pikërisht fakti që dispononin fletushka me figurën e luanit të Venedikut të shtypur në to.

Qarkullonin kështu frikëra nga komplete, trazira politike, që gjithsesi qartësoheshin prej stilit të jetës shembullor e të pastër të fretënve; marrjet e vazhdueshme në pyetje dëshmonin vetëm misionin e tyre fetar, arsye për të cilën rreth tyre ngushtoheshin përherë e më shumë vëmendja e kontrollet, të përziera dhe me kuriozitet, dhe mahnitja për jetën thellësisht të varfër, për më tepër dhe me interesin për të shfrytëzuar aftësitë e të sapoardhurve për të shëruar e pastruar të sëmurë e vise. Prania e të krishterëve dhe e myslimanëve duket e karakterizuar nga forma thellësisht fluide: përveç fortesave a kullave të të krishterëve nëpër male, objekt frike i përhershëm nga turqit e asnjëherë të mposhtura, të krishterët e zonave fushore përjetonin një status skllavërimi, por dhe njëfarë mirëqenieje: janë ata, p.sh., që ofrojnë dëmshpërblimin për fretnit. Por ata ishin plotësisht të paditur, shkruan kronisti; ndër ta vetëm dhjetë persona në të gjithë Shqipërinë mund të dinin të lexonin.

Na vjen të pyesim: çfarë lexojnë? Ata pak veta prej kujt ishin mësuar apo ushtruar? Mbi cilat tekste? Për fat të keq fra Angelo nuk shton asgjë mbi këtë çështje.

Myslimanët që një kohë kishin qenë të krishterë i ndiqnin me shumë dëshirë ceremonitë e fretënve, meshët, predikimet, ndërhyrjet për bekim mbi popullsinë dhe arat, pa dyshim të shtyrë nga besëtytni të caktuara, por duke dëshmuar njëherësh që ruanin një nënshtresë të praktikave të hershme, përtej kureshtjes mbi ngjarje krejt të reja dhe të papitura që arrinin të gjallëronin jetën që kalonte e zbehtë.

Prekës është respekti për vendet e kultit që improvizohen nga fretnit: nëse janë të krishterët ata që i ndihmojnë për të ndërtuar baraka të thjeshta me kashtë e tulla, myslimanët afrohen me dëshirë, e në njëfarë mënyrë receptojnë ritet dhe dëgjimin e tyre. Sigurisht ka peshën e vet dhe fakti që shpesh kanë gra të krishtera, dukuri që do të zgjasë për shekuj me radhë, duke qenë se dhe në shekullin e kaluar, në qendra rurale të Shqipërisë, një zakon i tillë ndeshet i pandryshuar.⁷ Por edhe klerikët turq, shkruan fra Angelo, shkonin me dëshirë të shihnin një imazh të Virgjënës Mari dhe gratë e tyre sillnin tufa me lule. Edhe në Gjakovë, me mbërritjen e dy fretënve që celebroyjnë meshë, janë bashkë të krishterë (vetëm njëzet shtëpi të tyre kanë mbetur) dhe mjaft myslimanë që vijnë për të asistuar.

Qëndron ndryshe çështja për qeveritarët: me përjashtim të disa rasteve të ndryshme të pashmangshme (p.sh., gruaja [në fakt, e ëma - red.] e Beut të

⁷ Khs. për këtë Luigi Za, I villaggi del dio Rodon. Il sistema di vita in un'area rurale albanese, Lecce, Besa Muci, 2021, botimi III (botimi I, 2001), me ese introductive "Capo Rodoni nella storia" nga Lucia Nadin.

Shkodrës që ndihmon misionarët duke përfitur nga mungesa e të shoqit [të birit – red.] apo mbledhësi i taksave i dërguar nga Stambolli që është i detyruar të ndjekë një politikë të dyfishtë ndaj tyre, zyrtarisht të ashpër, por tolerant me vepra, sanxhakbejtë e Shkodrës, Tivarit, Ulqinit, Lezhës, Krujës, tregohen të vendosur në refuzimin e pranisë së misionarëve në Shqipëri. Ai i Shkodrës që kundërshtari më i rreptë; sigurisht Shkodra ishte metropoli i vendit dhe pesha e qeverisjes ishte më e madhe, por Shkodra kishte qenë fortesa e katolikëve dhe aty, kuptohet, vërehej një intolerancë e fortë fetare.

Jo rastësisht në oratorin më të afërt të Shkodrës, pra, në zonën më nevralgjike, u dërgua misionari me një imazh më të fortë moral, fra Cherubino da Val di Bono, më i përgatitur meqë zotëronte dhe gjuhën shqipe, por sigurisht dhe më “i armatosuri” në betejën për besimin e tij.

Në kronikë vihet në dukje një ndryshim i thellë në çështje tolerance, e zbatuar nga turqit ndaj të krishterëve të ritit latin dhe “skizmatikëve”, duke u lënë këta të fundit shumë më të lirë meqë nuk vareshin nga Papa, të lirë mbi të gjitha për të ndërtuar manastire të bukura, me guida mjaft të përgatitura në pikëpamje kulturore përballë padijes së rëndë dhe sa u përket parimeve të fesë që sundonte në botën e religjiozëve të ritit latin.

Një pasazh nga teksti i fra Angelos duket i vyer për historinë e arsimit në Shqipëri.

Në mes të situatës katastrofike të popullit të të krishterëve, me mungesë dhe të principeve themelore të besimit dhe neneve të tij, spikat përvoja në Blinisht e fra Carlo dalla Mirandola-s që ngrii një shkollë të frekuentuar nga rreth pesëdhjetë të rinj të krishterë, një përvojë që pati një miratim të gjerë në popull e që shërbente për një përgatitje në shkrim e këndim e në virtytet e besimit të krishterë. Kronisti, nuk specifikon, për fat të keq, cili ishte programi i fra Carlo-s dhe cilat metoda përdorte. Mendohet që mësonte të lexonin, të shkruanin dhe ndihmonte në njohjen e katekizimit.

Duke u kthyer nga Roma Át Bonaventura kishte sjellë gjëra të domosdoshme për Misionin: përtej pajimeve të vogla që lidhen me ritin (fugure, oste kungimi), pa dyshim dhe ndonjë tekst, p.sh., Doktrina e krishterë e Bellarmino-s (mund të hipotetizohet), duke qenë një vepër që siç dihet, me botimin e vitit 1597 më tej pati një qarkullim mjaft të gjerë dhe përbente tekstin bazë për përkthimet në gjuhë të ndryshme. Puna për alfabetizimin ishte një nevojë urgjente e shprehur dhe prej meshtarëve dhe ipeshkvinjve të angazhuar në Shqipëri: të mendojmë, p.sh., për doktrinën e Pjetër Budit, që kishte përkthyer tekstin e Bellarminos në vitin 1618. Nga shënimet e fra Cherubino-s (siç do të vërehet më tej) do të mund të vihemi në dijeni që tekstet në përdorim ishin Ritualit dhe Pasëqyra e t’Rrëfyemit.

Mund të duket i tepruar një pohim i tillë, duke qenë se bëhej fjalë për përvoja të rralla, të cilat gjithsesi duhet të nënvizohen qoftë dhe për korrektësi në pikëpamje të rindërtimit historik të ngjarjeve. Edhe tekstet e Fra Cherubino-

s dhe të Leone da Cittadella-s do të shërbejnë, siç do të shihet, për të hedhur dritë mbi këtë çështje.

E lidhur me problemin specifik të pranisë së disa besimeve fetare në Shqipërinë e fillimit të shekullit XVII, një konsideratë e fundit lind nga teksti i shqyrtuar.

E qartë, por dhe e kuptueshme armiqësia e dëshmuar prej myslimanëve ndaj misionarëve, “të ndërfitur”, “fanatikë”, që guxonin të vinin në dyshim fenë e tyre e predikonin kundër vetë profetit të tyre Muhametit. Në marrjet në pyetje që u bëheshin fretënve bëhet i qartë respekti nga ana e myslimanëve ndaj shenjtorësh e profetësh të fesë së krishterë, e në të kundërt, siç është parë, qëndron ashpërsia e mendimit perëndimor që kishte arritur sa të vendoste Muhametin në ferr. Bëhet fjalë për marrje në pyetje klerikësh të burgosur mbi të cilët më parë është ushtruar dhunë. Ndërkohë, duhet vënë në dukje që gjithë kjo armiqësi ndaj predikuesve nuk rrjedh fort prej motivesh moskuptimi në plan teologjik, por nga dyshime politike dhe vetë reagimet jo të qeta janë të lidhura me ngjarje jo të zakonit në jetën e brendshme të vendit. Ja pra, pse ashpërsohet armiqësia ndaj fretënve dhe ndaj atyre që i ndjekin kur në Shqipëri mbërrin lajmi mbi episode të prishjes së marrëdhënieve me tregtarët turq që ishin në Venedik. Ndërkohë, mendohet që fretnit në këtë rasë mund të ishin mall shkëmbimi me të burgosurit në Venedik. Kështu edhe kur përhapet lajmi që fretnit janë dërguar në Zadrimë që të ndërtojnë një fortesë për venecianët dhe që shpërndajnë fletushka me figurën e luanit të Shën Markut. Kështu edhe kur ndodhin përleshje të forta e të mirëfillta mes venecianëve dhe turqve në afërsi të bregdetit të Vlorës.

Në tekst mund të gjenden shënime që paraqiten me rëndësi për historinë arkeologjike të ndërtesave fetare, si në rastin e ubikimit të saktë të rrënojave të kuvendit të domenikanëve jo larg prej kalasë së Shkodrës.

Mbetet dominues, në krejt rrëfimin, imazhi i përpjekjeve të një grushti burrash që besojnë fort, pothuaj të etur për t’u martirizuar, që vrapojnë gjithë kohën, që pësojnë poshtërsi përditë bashkë me rrënimin e vendeve ku strehohen, që rezistojnë me krenari në të gjitha marrjet në pyetje, që kalojnë muaj të tërë nëpër stalla të qelbëta me zinxhirë në qafë gjatë natës, të gatshëm për të predikuar e për të celebruar meshë gjatë ditës.

Nga ky këndvështrim, siç thoshim dhe në fillim, ngjarjet e rrefyera kapërcejnë interesin specifik fetar, e vënë dhe lexuesin agnostik apo jobesimtar në padurim e ankth, pothuaj si të gjitha tekstet klasike të çdo epoke historike, që shtrojnë dhe pyetje mbi zgjedhjet themelore në jetë.

Ndikimi i imazhit fillestar, ai i dy njerëzve të zbritur në një breg deti të zbrazët në tokë shqiptare, të vetmuar, të shtyrë nga një forcë e brendshme që të kërkonin rrugën në të cilën do të duhet të ecnin, vijon të mbetet i pashlyer, edhe pasi mbyllet faqet e relacionit; është pikërisht ai kuadër me dy silueta në një sfond të zbrazët që mbetet i paharruar pasi lexohen kujtimet e Fratit Angelo

nga Bergamo, të paktën për atë që shkruan, akoma më shumë se rrëfimet dramatike pasuese mbi vuajtje e ikje që reflektohen në skenarë me sequenca vizive të detajuara, sepse pikërisht ai kuadër është i ngarkuar me një fuqi të jashtëzakonshme evokative brenda një peizazhi pa një zë të vetëm.

Nuk është pa rëndësi të kihet parasysh koha së cilës i referohemi: 1634-1640. Nuk ka shpërthyer akoma lufta e Kretës mes Venedikut dhe Kostandinopojës, akoma nuk janë përballur frontet përkatëse në një luftë të mirëfilltë e akoma mbizotërojnë ato arsye tregtare që kishin bërë të hapej dhe Hambari i turqve në Venedik në vitin 1621. Me shpërthimin e konfliktit klima do të ndryshojë rrënjësisht, me pasoja të pashmangshme dhe në politikën e brendshme të Shqipërisë, por dhe për misionarët do të vijë koha e martirizimit.

Pikërisht për këtë do të bëhet fjalë në tekstin e Fra Cherubino-s nga Val di Bono.

Përktheu: **Evalda PACI**

